



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/M21-11 Prot.
Nr. Dok. 202503295/11

Tiranë 17/12/2025

Lënda: *Rekomandim për ndryshimin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Nr.651, datë 21.01.2019, "Për miratimin e procedurës së transportimit dhe shoqërimit të të burgosurve".*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Tiranë

Për dijeni: **Ministrisë së Drejtësisë**
Tiranë

I nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm,

Institucioni i Avokati i Popullit, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ka ndjekur me vëmendje kushtet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat e privuar nga liria në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Në këtë kuadër, theksojmë se vlerësojmë përpjekjet e bëra për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të burgosurit, nga strukturat përgjegjëse të shëndetësisë dhe ato të sigurisë në sistemin e burgjeve.

Por, gjatë vizitave monitoruese dhe trajtimit të ankesave të marra nga disa të burgosur, është vërejtur se respektimi i dinjitetit njerëzor dhe i privatësisë gjatë marrjes së shërbimit shëndetësor, paraqet ende mangësi që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme me qëllim forcimin e mekanizmave institucionalë dhe praktikave administrative që garantojnë mbrojtjen e dinjitetit dhe privatësisë së personave të privuar nga liria gjatë marrjes së shërbimit shëndetësor, si dhe sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së administratës së burgjeve me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Avokati i Popullit vlerëson se respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor në kushte që garantojnë dinjitetin dhe privatësinë e individit është një komponent thelbësor i trajtimit njerëzor, sipas kërkesave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe standardeve të përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) dhe Rregullat Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat Mandela).

Në vijim, po sjellim në vëmendjen tuaj disa nga gjetjet dhe konkluzionet e institucionit të Avokatit të Popullit, në trajtimin dhe hetimin administrativ të kryer për shqyrtimin e ankesës të _____, në lidhje me *“shkeljen e dinjitetit dhe cënimin e privatësisë”*, pasi gjatë vizitës mjekësore të kryer në klinikën _____, pretendohet se: *“punonjës të policisë së burgjeve, kanë qenë të pranishëm në dhomën e mjekut, gjatë procedurës së kryerjes së ekzaminimit _____”*.

I. Përshkrimi i rastit

Gjatë inspektimit periodik të zhvilluar në datën 31.07.2025, në IEVP Durrës, grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, ka marrë kontakt me _____, i cili, ndër të tjera, ka paraqitur ankesë lidhur me shkelje të dinjitetit njerëzor dhe cenim të privatësisë, gjatë vizitës mjekësore që ka kryer në klinikën _____, ku pretendon se rojet kanë qenë të pranishëm në sallë dhe gjatë procedurës paraprake të ekzaminimit _____.

Për shqyrtimin e ankesës së _____, institucioni ynë iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresat Nr. K2/M21-2 Prot., datë 14.08.2025; Nr.474, datë 13.08.2025 dhe Nr. K2/M21-8 Prot., datë 06.10.2025, ku kemi kërkuar të informohemi për sa më poshtë vijon:

- A është shoqëruar _____ në ndonjë klinikë private për të kryer ekzaminime mjekësore?
- A është ende në fuqi Urdhri Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Transportimi dhe shoqërimi i të Burgosurve”.
- A është plotësuar nga stafi i IEVP Durrës, formulari i treguesve të riskut dhe nevojave, gjatë shoqërimit të _____ për në klinikën private, në zbatim të procedurës së parashikuar në Urdhrin Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Transportimi dhe shoqërimi i të Burgosurve”? Nëse po, lutemi na dërgoni një kopje të këtij formulari, të plotësuar për rastin në fjalë.
- Sa ka qenë numri i personelit të punonjësve të Policisë së Burgjeve që kanë shoqëruar _____ për në klinikën private (nga këta sa kanë qenë staf mjekësor dhe sa punonjës të sigurisë)?

- Sa ka qenë numri i personelit të punonjësve të Policisë së Burgjeve që kanë qëndruar brenda dhomës së mjekut, gjatë kohës kur _____ ka kryer konsultë dhe ekzaminime mjekësore?

Në përgjigje të kërkesave tona, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar informacion me shkresat: Nr.12875/1 Prot., datë 21.08.2025; Nr.12997/1 Prot., datë 22.09.2025; dhe Nr.16054/1 Prot., datë 24.10.2025. Bazuar në këto informacione rezulton se:

Bazuar në kërkesën e IEVP Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka marrë masa për shoqërimin e _____ në Spitalin privat _____, në qytetin e Durrësit, në datën 17.07.2025 sipas rekomandimeve të Sektorit të Shëndetësisë për realizimin e një ekzaminimi _____.

Shoqërimi është kryer me Urdhër shoqërimi SH-17081/1, datë 16.07.2025, bashkëshoqëruar me Plan-Masash për mbarëvajtjen e sigurisë e shërbimit.

Për këtë shërbim janë planizuar 8 punojnës policie të rolit bazë, 2 drejtues automjetesh dhe një drejtues shërbimi Oficer. Ky planizim paraprak është kryer me arsyetimin e garantimit të sigurisë gjatë udhëtimit, sigurimin e mjeteve në parkim të përshtatshëm, sigurimin perimetrik të objektit Spital, sigurimin e ambienteve ku do të kryheshin vizitat/konsultat/ekzaminimet nga kati në kat i godinës etj.

Së bashku me grupin e shoqërimit ka qenë present edhe 1 ndihmësmjek i IEVP Durrës, i cili shoqëron të burgosurin gjatë ekzaminimeve dhe administron dosjen shëndetësore dhe dokumentacionin shoqërues.

Sa lidhet me qëndrimin e punonjësit të sigurisë brenda sallës gjatë kryerjes së ekzaminimeve mjekësore, sqarojmë se kjo është praktikë e unifikuar në aktet rregullative, ku gjatë çdo shoqërimi jashtë institucionit, i burgosuri ruhet e mbrohet pandërprerë. Në rastin konkret, gjatë kryerjes së ekzaminimeve dhe konsultave, prezent me të paraburgosurin ka qëndruar 1 punonjës policie.

*Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Policisë së Shtetit, në çdo rast kur të burgosurit do të shoqërohen jashtë institucionit për veprime procedurale, kryhen njoftimet përkatëse në drejtim të strukturave të Policisë Vendore, e cila merr masat në mënyrë të pavarur për mbështetjen e këtyre shërbimeve, kryesisht kur i burgosuri vlerësohet me rrisht të lartë, procedurë e cila **nuk** është aplikuar në rastin e shoqërimit të _____, pasi **nuk** paraqet rrezikshmëri.*

Në lidhje me _____, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk dispononte informacion operativ, si rrjedhojë masat e sigurisë dhe shoqërimit janë aplikuar pa forca shtesë nga strukturat e burgjeve apo të Policisë së Shtetit.

Evidentojmë se trajtimi i gjithanshëm i _____ është bërë konform të gjithë akteve ligjore rregullative, pa anshmëri apo diskriminim dhe me dinjitet të plotë ligjor e human.

Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ka sanksionuar qartazi disa detyrime që lidhen me shoqërimin jashtë institucionit dhe me ekspozimin e të burgosurit, përkatësisht neni 57, pika 1¹ dhe pika 3 e tij².

Referuar procedurës “Trasportimi dhe shoqërimi i të burgosurve”, kapitulli I, pika 1.2 përcaktohet se, “*Stafi multidisiplinar i IEVP-ve (siguri, social, shëndetësor, ligjor) është përgjegjës për vlerësimin e riskut të të gjithë të dënuarve dhe të paraburgosurve, kur është nevoja për shoqërim jashtë regjimeve të banimit*”. Në këtë formular përcaktohen dy shkallë të riskut, “*i lartë*” dhe “*standard*”. Bazuar në formularin e treguesve të riskut dhe nevojave Nr. Extra Prot., datë 17.03.2025, për _____, plotësuar nga IEVP Durrës, rezulton se ai është cilësuar me risk të shkallës “**Standard**”.

Në vijim të këtij hetimi administrativ, një grup pune i kryesuar nga Komisioneri i Seksionit të Veçantë, ka shkuar në vend në Klinikën _____, për të marrë një informacion më të plotë nga stafi mjekësor i kësaj klinike, si dhe për të kqyrur ambientin e dhomës së mjekut, ku janë kryer ekzaminimet e kërkuara prej tij.

Sipas shpjegimit të mjekut, i cili ka kryer ekzaminimin e _____, ky i fundit ka shprehur shqetësimin për praninë e punonjësve të policisë, brenda dhomës ku do të kryhej ekzaminimi. Mjeku i ka kërkuar punonjësve të policisë që të presin jashtë dhomës deri në përfundim të ekzaminimit, por ata **nuk** kanë plotësuar kërkesën e mjekut, duke thënë se kanë për detyrë të zbatojnë rregullat e sigurisë të miratuara për këto raste. Në këto rrethana, është dakortësuar që punonjësit e policisë të qëndrojnë brenda dhomës, me shpinë të kthyer nga shtrati ku do të kryhej kontrolli mjekësor i _____.

Nga kqyrja e ambientit të dhomës ku ishte kryer ekzaminimi, rezultoi se, kjo dhomë ishte një **ambient i hapur dhe i pandarë**, ku mundësia për të shmangur shikimin dhe dëgjimin nga personat e sigurisë që ndodheshin në dhomë, ishte e pashmangshme.

II. Baza ligjore dhe standardet ndërkombëtare

E drejta për privatësi në trajtimin shëndetësor është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila i njihet çdo individ, përfshirë edhe personave të paraburgosur apo të dënuar. Kjo e drejtë buron nga parimi i ruajtjes së dinjitetit njerëzor dhe është e garantuar nga një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare. Konkretisht:

¹ 1. Lëvizjet e burgosurit jashtë institucionit bëhen për aq sa është e mundur brenda një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast nën shoqërimin e personelit të Policisë së Burgjeve, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

² 3. Gjatë lëvizjes tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar të burgosurin sa më pak që të jetë e mundur para publikut, duke marrë masat e duhura mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e identitetit tij dhe të kushteve, që nuk cenojnë dinjitetin apo përkeqësojnë gjendjen e tij fizike.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ);
- Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- VKM Nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;
- Urdhri Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Për miratimin e procedurës së transportimit dhe shoqërimit të të burgosurve”.
- Të drejtat e pacientit³.
- Rregullat Evropiane për Burgjet (2006)⁴;
- Udhëzuesi mbi Rregulloren Evropiane të Burgjeve, të hartuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2023⁵;
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat e Nelson Mandela)⁶;
- Raporti i Komitetit Evropian për parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor, degradues apo poshtërues (CPT), i botuar më 12 janar 2024⁷, mbi vizitat e kryera në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri.
- Standartet e Komitetit Evropian për parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor, degradues apo poshtërues (CPT), mbi shërbimin shëndetësor në burgje, botuar në vitin 1993⁸.
- Rekomandimi Nr. R (98) 71 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, drejtuar shteteve Anëtare lidhur me aspekte etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg, botuar më 8 prill 1998⁹.

- Kushtetuta e RSH

Neni 15/2

“Organe e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

Neni 17

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.”

³ <https://www.qsut.gov.al/per-pacientet-dhe-familjaret/pritshmeria-e-pacientit/te-drejtat-dhe-detyrimet-e-pacientit/>

⁴ <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>

⁵ <https://edoc.coe.int/en/european-prison-reform/11595-guidance-document-on-the-european-prison-rules.html>

⁶ https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Nelson_Mandela_Rules-E-ebook.pdf

⁷ <https://rm.coe.int/1680ae233b>

⁸ <https://rm.coe.int/16806ce943>

⁹ <https://rm.coe.int/09000016804fb13c>

2. *Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut*".

Neni 25

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues".

Neni 28/5

"Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij".

Neni 30

"Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë".

- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3 i Konventës, sanksionon se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimeve, trajttimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 6 i Konventës, njeh të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe prezumimin e pafajsisë për çdo person të akuzuar për një vepër penale, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Neni 8 i Konventës, njeh të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

- Praktika e GJEDNJ

Një i burgosur nuk i humbet të drejtat e tij sipas Konventës vetëm për shkak të statusit të tij si i burgosur. Çdo ndërhyrje në të drejtat e Konventës, duhet të justifikohet brenda mundësisë dhe qëllimit të kufizimeve që ka vendosur Konventa.

Parimi kryesor ku mbështetet praktika e GJEDNJ-së, në lidhje me të drejtat e të burgosurve, është domosdoshmëria e **trajtimit me dinjitet të të gjithë personave të privuar nga liria dhe parandalimi i sjelljeve ose trajtimit çnjerëzor, poshtërues apo degradues**¹⁰.

¹⁰ https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_prisoners_rights_eng

Burgimi, si një masë që i heq lirinë një personi, sjell kufizime të natyrshme në jetën e tij private dhe familjare. Megjithatë, është pjesë thelbësore e së drejtës së një të burgosuri, mbrojtja e të dhënave personale.

Gjykata, ka theksuar se: “... mbrojtja e të dhënave mjekësore, është me rëndësi themelore për gëzimin e të drejtës së një personi për respektimin e jetës private dhe familjare, siç garantohet nga neni 8 i Konventës. Respektimi i konfidentalitetit të të dhënave shëndetësore është një parim jetësor në sistemet ligjore të të gjitha Palëve Kontraktuese të Konventës. Është thelbësore jo vetëm të respektohet ndjenja e privatësisë së një pacienti, por edhe të ruhet besimi i tij ose i saj në profesionin mjekësor dhe në shërbimet shëndetësore në përgjithësi.

Pa një mbrojtje të tillë, ata që kanë nevojë për ndihmë mjekësore mund të dekurajohen nga zbulimi i informacionit të tillë me natyrë personale dhe intime që mund të jetë i nevojshëm për të marrë trajtimin e duhur dhe, madje, nga kërkimi i një ndihme të tillë, duke rrezikuar kështu shëndetin e tyre...”¹¹.

Gjykata ka kërkuar që ligji vendas të ofrojë mbrojtje të përshtatshme për të parandaluar çdo komunikim ose zbulim të të dhënave personale shëndetësore, që mund të jetë në kundërshtim me garancitë e Nenit 8 të Konventës (Mockutė v. Lithuania, 2018, § 93).

- **Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, VKM Nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” dhe Urdhri Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Për miratimin e procedurës së transportimit dhe shoqërimit të të Burgosurve”.**

Legjislacioni i brendshëm për të burgosurit ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

Në çdo rrethanë, autoritetet publike nuk mund t’i shmangen detyrimit për të zbatuar nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku ndalohet ushtrimi i torturës, dënimeve, trajtimeve çnjerëzore ose **poshtëruese**. Kjo e drejtë është e paderogueshme sipas parashikimit të nenit 15, pika 2 të Konventës.

Jetesa në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale duhet të përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me jetën në komunitet dhe kufizimet duhet të zbatohen si përjashtim. Sipas legjislacionit të brendshëm¹², të drejtat e të burgosurit, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj.

¹¹ Z v. Finland case (25 February 1997, Reports 1997-I)

¹² Neni 8, pika 2 e Ligjit nr.81/2020 dhe neni 2, pika 7 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Sistemi i burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë, duhet të udhëhiqet nga parimi i lehtësimit të riintegrimin në shoqëri të personave, të cilëve u është hequr apo kufizuar liria¹³.

Nëse i burgosuri ka nevojë për trajtim shëndetësor, i cili nuk ofrohet nga shërbimet e kujdesit shëndetësor të institucionit ose kërkohet prej tij, merren masat për transferimin në shërbimet e kujdesit shëndetësor jashtë institucionit. Gjatë transportimit, i burgosuri shoqërohet nga mjeku ose ndihmësmjeku dhe punonjësi i sigurisë¹⁴.

Lëvizjet e burgosurit jashtë institucionit bëhen për aq sa është e mundur brenda një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast nën shoqërimin e personelit të Policisë së Burgjeve, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve. Gjatë lëvizjes tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar të burgosurin sa më pak që të jetë e mundur para publikut, duke marrë masat e duhura mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e identitetit tij dhe të kushteve, që nuk cenojnë dinjitetin apo përkeqësojnë gjendjen e tij fizike¹⁵.

Numri i punonjësve të sigurisë që bëjnë shoqërimin e të burgosurit të sëmurë në shërbimet e kujdesit shëndetësor jashtë institucionit caktohet në varësi të situatës, rrezikshmërisë, ambienteve, **por në asnjë rast jo më pak se 3 (tre) punonjës sigurie për një të burgosur**¹⁶.

Vizitat jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe mbikëqyrja spitalore kryhen bazuar në procedurën e sigurisë gjatë shoqërimeve, duke ruajtur konfidencialitetin e plotë të lëvizjeve dhe shmangur çdo lloj komunikimi dhe kontakti¹⁷.

I burgosuri i sëmurë që shtrohet në spital mbikëqyret nga punonjësit e sigurisë i pa prangosur¹⁸.

Në rastet kur i burgosuri është vlerësuar me nivel të lartë rrezikshmërie për t'u arratisur, kur shoqërohet jashtë dhomës ku është i shtruar, mund të përdoren mjete kufizuese për të parandaluar ndonjë arratisje të mundshme¹⁹.

Për sa i përket sigurisë dhe privatësisë së një të burgosuri, gjatë kryerjes së vizitës mjekësore brenda mjedisit të IEVP-së, në nenin 21, pika 4 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikohet se: *“Lëvizja e të burgosurit nga mjedisi i banimit për në infermieri dhe anasjelltas, me përjashtim të rasteve urgjente, bëhet një nga një, sipas kërkesës së mjekut. Gjatë konsultës dhe ekzaminimeve mjekësore, i burgosuri qëndron i paprangosur dhe punonjësi i sigurisë qëndron jashtë dhomës deri në mbarimin e vizitës”*.

¹³ Neni 12, pika 1 e Ligjit nr.81/2020 dhe neni 1, i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹⁴ Neni 41/5 i Ligjit nr.81/2020 dhe neni 109/1 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹⁵ Neni 57, pika 1 dhe 3 e e Ligjit nr.81/2020.

¹⁶ Neni 109/2 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹⁷ Neni 109/4 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹⁸ Neni 109/5 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹⁹ Neni 109/6 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Ndërsa, për sa i përket sigurisë dhe privatësisë së një të burgosuri, kur ai shoqërohet jashtë IEVP-së, rregullat parashikohen në Urdhri Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Për miratimin e procedurës së transportimit dhe shoqërimit të të burgosurve”.

Në pikën I të këtij Urdhri, parashikohen parimet dhe kërkesat e përgjithshme, ku ndër të tjera thuhet se:

- Niveli i masave të sigurisë, gjatë zbatimit dhe procedurave të shoqërimit dhe transportit, duhet të jetë në nivelin minimal të mundshëm, referuar kategorizimit të shkallës së sigurisë;
- Kur të burgosurit transferohen nga një burg në tjetrin ose lëvizin nga burgu në vende të tjera, sin ë gjykatë ose në spital, ata ekspozohen ndaj publikut sa më pak të jetë e mundur dhe merren masat e nevojshme për ruajtjen e anonimatit të tyre.

Në pikën 2.5 të Urdhrit, përcaktohet se:

“Në një shoqërim të zakonshëm, me një të dënuar ose të paraburgosur, kërkohet që numri i punonjësve të mos jetë më pak se tre punonjës.

Numri dhe niveli i personelit shoqërues duhet të përcaktohet duke kryer një vlerësim të rrezikut, që merr parasysh:

- *Numrin e të burgosurve që do të shoqërohen.*
- *Nivelin e mbykëqyrjes së të burgosurve.*
- *Natyrën e shoqërimit.*
- *Vendndodhjen e destinacionit të eskortës.*
- *Skemën e destinacionit të eskortës.*
- *Kohëzgjatjen e parashikuar të eskortës.*
- *Vlerësimin e gjasave që i burgosuri të tentojë arratisjen.*
- *Vlerësimin e kërcënimit të mundshëm të jashtëm.*
- *Aftësinë e të burgosurit për të bashkëpunuar, ose jo”.*

Rregullat për masat e sigurisë të të burgosurit gjatë qëndrimit për trajtim në qendrat spitalore, përcaktohen në pikën 4.2 të Urdhrit:

- a. *Dërgimi për trajtim mjekësor i të dënuarve/paraburgosurve bëhet me rekomandim të mjekut të IEVP, apo mjekëve të tjerë të qendrave spitalore.*
- b. *Sigurimi i të burgosurve në dhomat e qendrave spitalore kryhet nga jo më pak se tre punonjës policie.*
- c. *Në rast se në dhomë ka më shumë se një të dënuar/paraburgosur, shërbimi për ruajtjen e sigurimit të tyre kryhet me më shumë se tre punonjës policie.*
- d. *Punonjësi i policisë që kryen shërbim brenda në dhomë të jetë pa armatim personal dhe punonjësit që shërbejnë në koridor, ose në portën hyrëse, të jetë i paisur me armë krahu e brezi.*
- e. *Kur bëhet shërbim në ambientet e reamacionit, që janë ambiente të hapura dhe janë të shtruar edhe pacient të tjerë, punonjësit e policisë që janë tek reamacioni,*

mbajnë vetëm armatim personal. Punonjësit që shërbejnë në hyrjen e pavionit, mbajnë armë shërbimi.

- f. Punonjësit e policisë marrin masa për ruajtjen e sigurimin e dritareve të dhomës për parandalimin e tentativave për t'u arratisur nga të burgosurit.*
- g. **Kryerja e veprimeve nga personeli mjekësor të bëhet gjithmonë në prezencë të punonjësit të policisë.***
- h. Nxjerrja e të dënuarit/paraburgosurit jashtë dhomës për në tualet apo ambiente të tjera, të bëhet nën masa të forta sigurie duke kërkuar dhe punonjës policie shtesë, ku paraprakisht kryhet kontrolli i ambienteve të tualetit, apo ambienteve ku do të kryhen ekzaminimet mjekësore, sigurohen dritaret duke vënë me shërbim punonjës policie jashtë tyre etj.”.*

- **Rregullore Evropiane e Burgjeve²⁰ (miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 11 janar 2006)**

Detyrat e mjekut

42.3 Gjatë ekzaminimit të një të burgosuri, mjeku ose një infermier i kualifikuar, i cili i raporton një mjeku, duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- a) respektimit të rregullave të konfidencialitetit mjekësor;*

...

Siguria

51.1 Masat e sigurisë që zbatohen ndaj një të burgosuri, duhet të jenë minimumi i nevojshëm për të arritur mbajtjen e tyre të sigurtë.

- **Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve, Rregullat e Nelson Mandela²¹ (Rezoluta 70/175 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, shtojcë, e miratuar më 17 dhjetor 2015)**

Shërbimet e kujdesit shëndetësor

Rregulli 32

1. Marrëdhënia midis mjekut ose profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor dhe të burgosurve duhet të rregullohet nga të njëjtat standarde etike dhe profesionale si ato që zbatohen për pacientët në komunitet, në veçanti:

...

²⁰ <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>

²¹ https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Nelson_Mandela_Rules-E-ebook.pdf

c) Konfidencialitetin e informacionit mjekësor, përveç rasteve kur ruajtja e një konfidencialiteti të tillë do të rezultonte në një kërcënim real dhe të menjëhershëm për pacientin ose për të tjerët;

...

- **Raporti i Komitetit Evropian për parandalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor, degradues apo poshtërues (CPT), i botuar më 12 janar 2024²² dhe Raporti i përgjithshëm i CPT, mbi standartet e shërbimit shëndetësor në burgje, botuar në vitin 1993²³.**

Komiteti European për parandalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor, degradues apo poshtërues, në muajin Maj 2023, ka inspektuar disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, ku ndër to edhe IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, IEVP Fier, IEVP Peqin dhe IEVP Tepelenë.

Në përfundim të inspektimeve, CPT ka botuar raportin e konstatimeve dhe rekomandimeve, ku për sa i përket vizitave mjekësore, ka konstatuar mungesë të konfidencialitetit gjatë vizitave mjekësore të të burgosurve. Më konkretisht, në fq. 27, pika 77 vërehet se:

“77. Vëzhgimet e bëra nga delegacioni gjatë vizitës, treguan se konfidencialiteti mjekësor ishte larg të qenit i respektuar në burgjet e vizituara, pavarësisht rekomandimeve të përsëritura të Komitetit mbi këtë temë. Rezultoi se konsultat mjekësore të të burgosurve (përfshirë edhe gjatë pranimin në burg) zakonisht kryheshin në prani të stafit të sigurisë ose brenda rrezes së dëgjimit të tyre.

*Për këtë çështje, CPT-ja ka marrë në konsideratë informacionin e dhënë nga autoritetet shqiptare pas vizitës se “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve do të dërgojë një urdhëresë në të gjitha burgjet për të tërhequr vëmendjen e stafit për çështjen e konfidencialitetit gjatë konsultave mjekësore”. Megjithatë, Komiteti i duhet të përsërisë **se nuk mund të ketë asnjë justifikim për praninë sistematike të oficerëve të burgut gjatë ekzaminimeve mjekësore.** Prania e tyre është e dëmshme për krijimin e një marrëdhënieje të duhur mjek-pacient dhe zakonisht është e panevojshme nga pikëpamja e sigurisë. Për më tepër, prania e stafit të burgut mund t’i dekurajojë të burgosurit të japin shpjegime për shkakun e çdo dëmtimi që kanë pësuar. **CPT-ja u bën thirrje edhe një herë autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa në të gjithë sistemin e burgjeve për të siguruar që parimi i mësipërm të respektohet plotësisht gjatë ekzaminimeve mjekësore të të burgosurve**”.*

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve **duhet të adresojë në mënyrë thelbësore gjetjet dhe rekomandimet e CPT-së** dhe të marrë masa proaktive për të siguruar që kuadri rregullator në fuqi, të jetë në përputhje me këto standarte.

²² <https://rm.coe.int/1680ae233b>

²³ <https://rm.coe.int/16806ce943>

Ndërsa, në Raportin e përgjithshëm të CPT, mbi standartet e shërbimit shëndetësor në burgje, botuar në vitin 1993, përshkruhen disa nga çështjet kryesore të ndjekura nga delegacionet e CPT-së, kur këqyrin shërbimin e kujdesit shëndetësor **brenda** burgjeve. Një nga këto çështje të trajtuara në Raport, është ajo e konfidencialitetit, ku në pikën C/ii) rekomandohet:

50. Sekreti mjekësor duhet të respektohet në burgje në të njëjtën mënyrë si në komunitet. Mbajtja e dosjeve të pacientëve duhet të jetë përgjegjësi e mjekut.

*51. Të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve (qoftë me mbërritjen e tyre në burg apo në një fazë të mëvonshme) nuk duhet të dëgjohen, përveçse kur e kërkon mjeku përkatës, dhe **nuk** duhet të mbikëqyren me shikim nga oficerët e burgut. Për më tepër, të burgosurit duhet të ekzaminohen individualisht, jo në grupe.*

- **Rekomandimi Nr. R (98) 71 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve Anëtare lidhur me aspekte etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg, botuar më 8 prill 1998.**

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, i rekomandon qeverive të shteteve anëtare, të marrin në konsideratë, gjatë shqyrtimit të legjislacionit dhe në praktikën e tyre në fushën e ofrimit të kujdesit shëndetësor në burg, parimet dhe rekomandimet e përcaktuara në shtojcën e Rekomandimit Nr. R (98) 71, ku në pikën I/C/13, parashikohet se:

Konfidencialiteti mjekësor duhet të garantohet dhe të respektohet me të njëjtën rigorozitet si në të gjithë popullsinë.

- **Të drejtat e pacientit²⁴ (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 657, datë 15.12.2010).**

Në pikën 6 të Kartës Shqiptare të të drejtave të pacientit përcaktohet e drejta për Privatësi dhe Konfidencialitet, sipas së cilës:

Çdo pacient ka të drejtën e konfidencialitetit të të dhënave personale, përfshirë informacionet lidhur me gjendjen e tij/e saj shëndetësore dhe potencialit të procedurave diagnostike ose terapeutike, si edhe mbrojtje e privatësisë së tij/saj gjatë kryerjes së analizave diagnostike, vizatave të specialistit, dhe trajtimeve mjekësore/kirurgjikale në përgjithësi.

Të gjitha të dhënat dhe informacionin lidhur me gjendjen shëndetësore të një pacienti, dhe trajtimeve mjekësore/kirurgjikale që ai ose ajo është bërë subjekt, duhet të konsiderohen si private, dhe si të tilla, mbrohen në mënyrë bindëse (adekuate).

²⁴ fsdksh.gov.al/wp-content/uploads/2019/10/Karta-Shqiptare-e-te-Drejtave-te-Pacienteve.pdf

Privatësia personale duhet të respektohet, edhe gjatë kursit të trajtimit mjekësor/kirurgjikal (analiza diagnostike, vizitave të specialistit, mjekimeve), të cilat duhet të kryhen në një ambient të përshtatshëm dhe në prezencë vetëm të atyre që janë absolutisht të nevojshëm për të qenë aty (përfshihen rastet ku pacienti ka dhënë pëlqimin ose ka bërë kërkesë për të mos pasur asnjë prezent).

III. Konstatimet

Nga shqyrtimi i ankesës dhe informacionit të mbledhur, Avokati i Popullit vëren se:

- Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe VKM Nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, nuk përcaktojnë rregulla për sa i përket privatësisë të të burgosurit, kur ai kryen vizita mjekësore jashtë IEVP-së, por vetëm kur ai kryen vizita mjekësore brenda mjediseve të IEVP-së.

- Urdhri Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Transportimi dhe shoqërimi i të Burgosurve”, për sa i përket procedurës së sigurisë, sipas së cilës, *kryerja e veprimeve nga personeli mjekësor të bëhet gjithmonë në prezencë të punonjësit të policisë, cënon të drejtën për respektimin e jetës private dhe parimin e konfidencialitetit mjekësor.*

IV. Vlerësimi institucionit të Avokatit të Popullit:

Tërësia e legjislacionit dhe standardeve të lartpërmendura, vendosin dy parime thelbësorë në marrëdhënien mjek-pacient, të cilat janë ruajtja e konfidencialitetit dhe respektimi i privatësisë. Këto dy parime janë të zbatueshme si për pacientët, të cilët jetojnë në gjendje të lirë, ashtu edhe për ata, të cilët jetojnë në kushte kufizimi, për shkak të masave të sigurisë.

Konfidencialiteti është thelbësor për besimin midis profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe pacientëve. Pa të, pacientët mund të ngurrojnë të zbulojnë informacione personale, dhe kjo mund të ndikojë në kujdesin dhe trajtimin e tyre.

Konfidencialiteti në kujdesin shëndetësor është mbrojtja e informacionit personal të një pacienti, duke përfshirë shëndetin, familjen, stilin e jetës dhe nevojat e kujdesit. Kjo bëhet për të mbrojtur privatësinë e pacientit gjatë kujdesit të tij dhe madje edhe pas vdekjes.

Udhëzuesi mbi Rregulloren Evropiane të Burgjeve, i hartuar nga Këshilli i Evropës, në faqet 60-61, i kushton vëmendje respektimit të parimit të konfidencialitetit nga ana e stafit të burgjeve, ku në kapitullin *Detyrat etike dhe standardet profesionale*, shtjellohen detyrimet brenda regjimit të burgjeve:

“Stafi i kujdesit shëndetësor në burgje është i detyruar të zbatojë të njëjtat parime etike dhe detyra profesionale që rregullojnë punën e tyre në komunitetin e gjerë. Standardet

ndërkombëtare të të drejtave të njeriut njohin zbatimin e këtyre parimeve të rëndësishme etike në kontekstin e burgjeve. Stafi i kujdesit shëndetësor në burgje duhet të veprojë në pavarësi të plotë klinike në mjediset e burgjeve dhe duhet të marrë vendime bazuar vetëm në kritere mjekësore. Vendimi i stafit të kujdesit shëndetësor nuk mund të anulohet ose injorohet nga jo-klinikistë, përfshirë stafin e burgjeve. Stafi i kujdesit shëndetësor mund të jetë i prekshëm nga “besnikëria e dyfishtë” midis detyrave të tyre profesionale dhe ndaj autoriteteve të burgjeve. Si praktikë e mirë dhe për të garantuar pavarësinë klinike, stafi i kujdesit shëndetësor në burgje duhet të punësohet nga autoritetet e kujdesit shëndetësor dhe jo nga autoritetet e sistemit penitenciar. Parimi i konfidencialitetit është një gur themeli i etikës mjekësore dhe është veçanërisht i rëndësishëm në mjediset e burgjeve. Të burgosurit duhet të ndihen të lirë të diskutojnë çdo çështje mjekësore me stafin e kujdesit shëndetësor në konfidencialitet të plotë dhe të zhvillojnë konsulta individuale private sipas nevojës. Kjo do të jetë veçanërisht e rëndësishme në rastet kur të burgosurit mund të duan të zbulojnë pretendime për torturë ose keqtrajtim ose, në rastin e grave, çështje rreth dhunës me bazë gjinore. Detyrimet e konfidencialitetit mjekësor pasqyrohen në standardet ndërkombëtare mjekësore.

Stafi i kujdesit shëndetësor duhet të garantojë gjithmonë konfidencialitetin mjekësor dhe mund ta shkelë këtë rregull vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur ekziston një rrezik i menjëhershëm dëmtimi i pacientit ose të tjerëve dhe duhet të zbulohet në bazë të “nevojës për të ditur” me pëlqimin e pacientit. Të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen në privaci, përveç nëse kërkohet ndryshe nga mjeku përkatës dhe larg dëgjimit dhe shikimit të stafit të burgut”.

Parimi i konfidencialitetit dhe e drejta për respektimin e jetës private shtrihet jo vetëm në marrëdhënien e të burgosurit me mjekun e IEVP-së, por edhe me mjekët e spitaleve jashtë burgjeve.

Kufizimi i të drejtës për respektimin e jetës private duhet të përmbushë kriteret e vendosura në nenin 8/2 të Konvetës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Procedura e përcaktuar në Urdhrin Nr.651, datë 21.01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Transportimi dhe shoqërimi i të burgosurve”, sipas së cilës, kryerja e veprimeve nga personeli mjekësor të **bëhet gjithmonë** në prezencë të punonjësit të policisë, **nuk** përmbush kriteret e nenit 8/2 të Konvetës, për kufizimin e të drejtës për respektimin e jetës private si dhe cenon parimin konfidencialitetit mjekësor.

Detyrimi i vendosur në Urdhrin Nr.651, datë 21.01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për punonjësit e policisë, që të jenë të pranishëm kur mjeku kryen veprime me të burgosurin, në çdo rast të trajtimit të tij jashtë IEVP-së, nuk ruan një ekuilibër të drejtë apo proporcional midis sigurisë dhe privatësisë.

Ekzaminimet mjekësore duhet të kryhen me respekt të plotë të privatësisë së personit. Prania e stafit të sigurisë gjatë ekzaminimit apo konsultave, duhet të lejohet vetëm kur plotësohen dy kushte:

- E kërkon shprehimisht mjeku, për arsye të sigurisë së tij.
- Stafi multidisiplinar i IEVP-së (siguri, social, shëndetësor, ligjor), ka vlerësuar se për shkak të rrezikshmërisë që paraqet i burgosuri, ai duhet të mbikëqyret nga punonjës të policisë, gjatë ekzaminimit apo konsultës mjekësore, që do të kryhet jashtë IEVP-së.

Prania e policisë në këto raste, **duhet të jetë përjashtim nga rregulli dhe të lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme sigurie**, duke iu bërë me dije paraprakisht edhe pacientit.

Nëse gjatë ekzaminimeve mjekësore (veçanërisht intime) të të burgosurve, punonjës të sigurisë do të jenë të pranishëm, pa kërkesën e mjekut dhe pa arsye sigurie të dokumentuar, kjo do të përbëjë cenim të standardeve ndërkombëtare për trajtim me dinjitet të personit dhe mund të cilësohet si shkelje e nenit 8 të Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), dhe në raste të përsëritura ose poshtëruese, shkelje e nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues).

Në këto rrethana, çmojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të adresojë me përparësi këtë çështje dhe të ndërmarrë veprimet procedurale për ndryshimin e Urdhrit Nr.651, datë 21.01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve *“Për miratimin e procedurës së transportimit dhe shoqërimit të të burgosurve”*, për sa i përket procedurës së sigurisë, kur të burgosurit kryejnë ekzaminime/konsulta mjekësore jashtë IEVP-së.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

- Ndryshimin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Nr.651, datë 21.01.2019 *“Për miratimin e procedurës së transportimit dhe shoqërimit të të burgosurve”*, me qëllim marrjen e masave të sigurisë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në rastin kur të burgosurit kryejnë ekzaminime/konsulta mjekësore jashtë IEVP-së, vlerësimi i rriskut të kryhet në varësi të formularit të plotësuar nga IEVP-të, duke përmbushur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, për respektimin e dinjitetit njerëzor, të drejtës për jetë private, si dhe parimit të konfidencialitetit mjekësor.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V